RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË"

Tiranë, më 13.12.2021

PËRMBAJTJA

Nr.		EMËRTIMI	Faqe
I.		**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4**
	1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**4**
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**4-6**
	3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	**6**
II.		**HYRJE**	**6**
	1	Objekti i auditimit	**6**
	2	Qëllimi i auditimit	**7**
	3	Identifikimi i çështjes	**7**
	4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**7-8**
	5	Përgjegjësitë e audituesve	**8**
	6	Kriteret e vlerësimit	**8**
	7	Standardet e auditimit	**9**
	8	Metodat e auditimit	**9**
	9	Dokumentimi i auditimit	**9**
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**9**
	1	**Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	**9-10**
	2	**Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**	**10**
	2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK		**10-13**
	a.	*Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK*	10
	b.	*Burimet njerëzore në TIK*	10-13
	2.2Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit.		**14-20**
	a.	*Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi.*	14-20
	2.3Auditimi i sigurisë së informacionit		**21-27**
	a.	*Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK*	21-27
	2.4Auditimi i sistemeve		**28-37**
	a.	*Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*	28-37
IV.		**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**38-44**

Tabelë Shkurtimesh

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1	**ISUV**	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
2	**LIMS**	Laboratory information management system
3	**MBZHR**	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
4	**AKSHI**	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
5	**AKCESK**	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
6	**DAP**	Departamenti i Administratës Publike
7	**ASPA**	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
8	**BCP**	Business Continuity Plan
9	**RTO**	Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes
10	**RPO**	Objektivat e Punës së Ripërtëritjes
11	**KLSH**	Kontrolli i Lartë i Shtetit
12	**MNSH**	Marrëveshje Nivel Shërbimi
13	**ID**	Numri i Identifikimit
14	**OE**	Operator Ekonomik
15	**TI(IT)**	Teknologjia e Informacionit
16	**TIK**	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
17	**VKM**	Vendim i Këshillit të Ministrave
18	**IP**	Internet Protocol
19	**KVO**	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
20	**WHO**	Organizata Botërore e Shëndetësisë
21	**OiE**	Organizata Botërore e Shëndetit të Kafshëve
22	**EFSA**	Agjencia Evropiane e Ushqimit
23	**EU-RL**	Laboratorë Evropiane të Referencës
24	**HTTPS**	HyperText Transfer Protocol Secure
25	**HTTP**	HyperText Transfer Protocol
26	**XSS**	Cross-Site Scripting
27	**CPU**	Central processing unit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në vijimësi "ISUV", nga data 17.09.2021 deri më datë 19.11.2021.
Grupi i auditimit pas mbledhjes së informacionit gjatë fazës studimore nëpërmjet intervistave dhe pyetësorëve përcaktoi zonat më me risk.
Kërkesat për informacion sipas fushave përkatëse u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, ndërsa me Manualin Aktiv të auditimit IT u analizuan dhe vlerësuan elementët më të rëndësishëm të matricave.

I.1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit:

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, është bërë bazuar në një analizë risku, gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemit të teknologjisë që ISUV disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimmarrjen.
Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: "*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria*".

I.2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit "Mirëmbajtjen e sistemit LIMS", grupi auditimit analizoi komponentët e përshkruar në raportet e mirëmbajtjes mbi operimin e këtyre komponentëve onsite në sistem. Nga auditimi onsite në sistem u konstatua se nga 13 komponentë në total të përshkuara dhe kërkuara në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit LIMS, 7 (shtatë) prej këtyre komponentëve nuk janë të implementuara. Për këto komponentë Autoriteti Kontraktor ka	Faqe 14-20	e lartë	Titullari i Institucionit të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.

	kryer pagesa sipas raporteve dhe faturave të paraqitura nga Kontraktori (OE) (A. Shpk), me vlerën 1,704,000 Lekë., vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit.			
2.	Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se: - Ky sistem nuk të jep mundësinë e filtrimit dhe gjenerimit të raporteve. -Nuk ka eksport për të dhënat (informacionet) jep vetëm total rekordesh. Mungesa e gjenerimit të raporteve sjell pamundësinë e monitorimit të sistemit, mospërdorimin e data bazës për analizime statistikore dhe raportime javore ose mujore në varësi të nevojave të institucionit, si dhe mungesën e politik bërjes specifike sipas rajoneve, grupeve ushqimore, grup kafshësh, etj.	faqe 28-37	e lartë	ISUV të kërkojë tek OE përmbushjen e funksionaliteteve që mungojnë, për gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS.
3.	Nga auditimi mbi sigurinë e bazës së të dhënave të sistemit LIMS për periudhën 01.01.2019 deri më 30.06.2021 u konstatua se janë kryer veprime duke krijuar 951 "Hendeqe" në fushën ID. Ky konstatim tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimental rritës, si pasojë krijohet mundësia për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe nuk është e mundur ndjekja e rrjedhës historike të dhënave të sistemit. Nisur sa më sipër personat të cilët kanë akses në bazën e të dhënave kanë kryer sistemime apo fshirje të të dhënave duke gjeneruar ID me Hendeqe, pa autorizim nga personat përgjegjës në ISUV.	faqe 21-27	e lartë	ISUV të marrë masa për verifikimin e situatës së krijuar në lidhje me "Hendeqet" në fushën ID, duke hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.
4.	Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk disponon strategji të Teknologjisë se Informacionit. Po ashtu, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon as një strategji institucionale.	faqe 10-13	e lartë	ISUV duhet të ndërmarrë masa për ndërtimin e një plani strategjik për teknologjinë e informacionit, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave që ISUV zotëron dhe përpunon, në të cilën të adresohen qartë objektivat e institucionit.
5.	Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka të miratuar respektivisht nga MBZHR dhe AKSHI, Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë" dhe Rregulloren për Sigurinë e Informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.	faqe 10-13	e lartë	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në bashkëpunim me MBZHR dhe AKSHI-n duhet të marrë masa për miratimin e rregulloreve në bazë të së cilave institucioni mbështet veprimtarinë e tij.

I.3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e strategjisë institucionale dhe mungesa e strategjisë në drejtim të teknologjisë së informacionit, mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetje e veprimtarisë së ISUV.
Mungesa e strukturës së teknologjisë së informacionit në ISUV dhe akteve rregullatore mbi identifikimin e nevojave të TI, ka sjellë që trajtimi dhe zgjidhja e problematikave të shfaqura, të mbartin risk të lartë në drejtim të sigurisë së të dhënave.
ISUV ka investuar në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit pa zbatuar përcaktimet ligjore dhe nënligjore si dhe bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre duke mos përdorur me efektivitet fondet e buxhetit të shtetit.
Investimet në sistemet e teknologjisë së informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e vazhdueshmërisë së biznesit dhe nuk kanë siguruar rimëkëmbjen nga katastrofat.
Në opinionit e grupit të auditimit, ISUV për zhvillimin e shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe standardet e AKSHIT.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 973/1 prot, datë 06,10.2021 miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 17.09.2021 deri në 19.11.2021, në subjektin e auditimit Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në vijimësi"ISUV", ku periudha e audituar ishte 01.01.2020 deri në 30.06.2021, u krye auditimi me objekt "Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit", nga audituesit:

1. M.H., *përgjegjës grupi;*
2. M.P., *anëtare;*
3. R.A., *anëtar.*

II.1.Objekti i auditimit

*Objekti i AuditimitTIK*është përcaktimi nëse institucioni arrin objektivat e tij duke përdorur burimet IT në mënyrë efektive dhe në përputhje me: kërkesat ligjore/rregullative, integritetin, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2.Qëllimi i auditimit:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në ISUV, nga data 17.09.2021 deri më datë19.11.2021. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Qëllimi i AuditimitTIK*është *v*lerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TI dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

II.3.Identifikimi i çështjes:

Grupi i auditimit pas marrjes së informacionit nga subjekti dhe përpunimit të tij vlerësoi me risk drejtimet e auditimit si më poshtë:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. *Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK*
b. *Burimet njerëzore në TIK*

Elementet kryesorë që do të auditohen janë: Strategjia, procedurat dhe rregulloret e hartuara për teknologjinë e informacionit, burimet njerëzore të jashtëm apo të brendshëm të angazhuar për mbarëvajtjen e TI, përshkrimet e punës si dhe kualifikimet e kërkuara apo të fituara për ushtrimin e detyrave funksionale.

2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a. *Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi*

Auditimi drejt këtij moduli do të ketë në fokus vlerësimin sesi ISUV menaxhon, kontrollon dhe zhvillon blerjet dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit në fushën e TI.

3. Siguria e Informacionit

a. *Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK*

Auditimi drejt këtij moduli do të ketë në fokus vetëm mekanizmat, identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit në institucionin në auditim.

4. Auditimi i sistemeve

a. *Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output*

Verifikim i kontrolleve të aplikacionit për të dhënat Input/Output ka si qëllim të vlerësojë kontrollet e implementuara në aplikacion si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të objektivave të institucionit.

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:

ISUV bazuar në VKM nr. 515 datë 19.07.2006, "Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit" ka këto përgjegjësi:

-ISUV përgjigjet për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazorë;

-Në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO), Organizatën Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OiE), Agjencinë Evropiane të Ushqimit (EFSA) dhe Laboratorë Evropiane të Referencës (EU-RL) kryen konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme epizootike, agjentëve zoonotik dhe zbulimin e kontaminantëve që vijnë nga ushqimet;

-të përmirësojë strukturën analitike drejt validimit dhe akreditimit të shërbimeve;

-të zgjidhë pasiguritë gjatë survejancës së sëmundjeve të kafshëve, agjentëve zoonotike, rezistencës antimikrobike, dhe të shpërthimeve të sëmundje në njerëz;

-të koordinojë zbatueshmërinë e metodave të provës bazuar në rregulloret, ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare;

-të organizojë trajnime formimi dhe testime krahasuese;

-të japë vazhdimisht mbështetje teknike që autoritetet kompetente të vlerësojnë/menaxhojnë komunikojnë me efikasitet riskun.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve:
Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditoi ISUV, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 30.06.2020, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.
Nga grupi i auditimit, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 973/1 prot, datë 06.10.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit si dhe në legjislacionin e fushës në të cilën operon ISUV. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur për nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve.

II.6. Kriteret e vlerësimit:
Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raportkrahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.
Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT;
- Ligji i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar;
- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014;
- Rregullore "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike";
- Ligj Nr.10 465, Datë 29.9.2011 Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë;
- Ligj Nr.9863, Datë 28.1.2008 Për Ushqimin(i ndryshuar);
- Politikat, vendimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Legjislacionin, procedurat, normat dhe praktikat e komunitetit Europian dhe Institucioneve të tjera ndërkombëtare;
- Ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve";
- Ligji nr. 152/2013 për Nëpunësin Civil (Ndryshuar me ligjin nr, 178/2014, datë 18.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211);
- Ligj nr. 7961 dt. 12.07.1995 Kodi i Punës;
- VKM 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 "Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit", i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 "Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore";
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".

II.7.Standardet e auditimit:
Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit, duke përfshirë intervista, testime, analiza të të dhënave të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë,

duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310 si dhe standardet ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit.

II.8. Metodat e auditimit:

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në ISUV, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullator të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.9.Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

ISUV është institut i referencës kombëtare dhe është organizuar në bazë të VKM nr. 515 datë 19.07.2006, “Për ristrukturimin e Instituteve Kërkimore Shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

Misioni i ISUV: Ka si mision të garantojnë konsumatorin në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimore sipas qasjeve "Nga Ferma në Tavolinë" dhe "Një Shëndet".
Në këtë kontekst ISUV është angazhuar:
- të përmirësojë strukturën analitike drejt validimit dhe akreditimit të shërbimeve;
- të zgjidhë pasiguritë gjatë survejancës së sëmundjeve të kafshëve, agjentëve zoonotike, rezistencës antimikrobike, dhe të shpërthimeve të sëmundje në njerëz;
- të koordinojë zbatueshmërinë e metodave të provës bazuar në rregulloret, ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të organizojë trajnime formimi dhe testime krahasuese;
- të japë vazhdimisht mbështetje teknike që autoritetet kompetente të vlerësojnë/menaxhojnë komunikojnë me efikasitet riskun.

Objektivat e ISUV:
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është qendra e vetme e referencës në Shqipëri, e cila ka certifikim kombëtar dhe ndërkombëtar për një sërë analizash. ISUV varet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe është përgjegjëse për hartimin e strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe shpendëve. ISUV ka në varësi teknike 8 Laboratorë Rajonalë (LR), të cilët janë

përgjegjës për gjurmimin, analizimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve infektive e parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe në shpendë.
ISUV përgjigjet për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe jo shtazorë. Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) ndjek Sëmundjet me Origjinë Ushqimore (SOU).
ISUV bashkëpunon ngushtësisht me Organizatën e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO), Organizatën Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OiE), Agjencinë Evropiane të Ushqimit (EFSA) dhe Laboratorë Evropiane të Referencës (EU-RL) për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme epizootike, agjentëve zoonotik dhe zbulimin e kontaminantëve që vijnë nga ushqimet.
Nisur sa më sipër, grupi i auditimit vlerësoi me rëndësi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, me qëllim vlerësimine kontrolleve dhe mekanizmat që janë ndërtuar për krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TI dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.

a. Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK

Objektivi: Konfirmimi nëse ekziston një strategji TI, e cila përfshin plan TI dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e institucionit. Garantimi se ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat që mundësojnë institucionin të arrijë qëllimin e tij.
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është një institucion reference i cili funksionon mbi bazën ligjore si më poshtë:
- Ligji nr. 10 465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 71/2020;
- Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008, "Për Ushqimin" i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2020;
- Ligji nr. 105/2016, datë 14.10.2016 "Për mbrojtjen e bimëve";
- Ligji nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" dhe aktet nënligjore në funksion të tij të ndryshuar;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar;
- Rregullorja e Brendshme e funksionimit të ISUV me manualet e Menaxhimit të Cilësisë që përcaktojnë rregullat e përgjithshme.

Teknologjia e Informacionit në ISUV zhvillohet pa një strategji TI, pa plane dhe procese për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, dhe lidhjen e saj me strategjinë dhe objektivat e institucionit.
Nuk ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat që mundësojnë institucionin të arrijë qëllimin e tij.
Përsa i përket auditimit të dokumentimit të politikave dhe procedurave që lidhen me teknologjinë e informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, ka rezultuar se "Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë" në bazë të së cilës institucioni funksionon nuk është e miratuar nga ministria.
Po ashtu, nisur nga rëndësia që kanë sistemet e informacionit mbi mbarëvajtjen e institucionit, ISUV ka hartuar "Rregullore për Sigurinë e Informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë" e cila është dërguar për miratim nga Agjencia

Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me shkresë nr. 591/2 Prot. datë 08.09.2020 por ende nuk është miratuar.

b. Burimet njerëzore në TIK

Objektivi: Elementet kryesorë që do të auditohen janë: Përshkrimet e punës në këtë strukturë, ndarja e detyrave, zhvillimi i burimeve njerëzore.
Struktura aktuale e funksionimit të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë bëhet në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 23.10.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV", e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave. ISUV ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 99 punonjësish. Aktualisht, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë 12 vende vakante, për të cilat institucioni duhet të ndërmarrë masa për ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur organigrama e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë:



Figura nr.1: Organigrama.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në strukturën e tij, nuk ka një sektor më vete për teknologjinë e informacionit por ka vetëm një specialist TI, i cili është në varësi të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe përshkrimi i tij i punës bëhet sipas rregullave në fuqi të DAP. ISUV duhet të ndërmarrë masa për analizimin e nevojave për specialistë TI, në mënyrë që të sigurohet mbarëvajtja e institucionit.

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Trajnimet që punonjësit kryejnë nga ASPA nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e stafit për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

1. Titulli i gjetjes: ISUV nuk ka të miratuara rregulloret në bazë të së cilës funksionon.
Situata: Nga auditimi i dokumentimit të politikave dhe procedurave që lidhen me teknologjinë e informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, ka rezultuar se "Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë" në bazë të së cilës institucioni funksionon nuk është e miratuar nga MBZHR.
Po ashtu, nisur nga rëndësia që kanë sistemet e informacionit mbi mbarëvajtjen e institucionit, ISUV ka hartuar "Rregullore për Sigurinë e Informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë" e cila është dërguar për miratim nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me shkresë nr. 591/2 Prot. datë 08.09.2020 por ende nuk është miratuar.
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
Ndikimi/efekti: Risk në mos realizim i objektivave institucional.
Shkaku: Mos marrja e masave dhe hapave konkret nga niveli menaxherial për miratimin e akteve nënligjore ku institucioni mbështet aktivitetin e tij.
Rëndësia: E lartë
1.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në bashkëpunim me MBZHR dhe AKSHI-n duhet të marrë masa për miratimin e rregulloreve në bazë të së cilave institucioni mbështet veprimtarinë e tij.

2. Titulli i gjetjes: ISUV nuk disponon strategji të Teknologjisë së Informacionit.
Situata: Nga auditimi u konstatua se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon një strategji mbi teknologjinë e informacionit. Po ashtu, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon as një strategji institucionale.
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti: Mungesa e një strategjie mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së ISUV.
Shkaku: Mos zbatimi i praktikave më të mira në zhvillimin dhe menaxhimin institucional.
Rëndësia: E lartë
2.1 Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për ndërtimin e një plani strategjik për teknologjinë e informacionit, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave që ISUV zotëron dhe përpunon, në të cilën të adresohen qartë objektivat e institucionit.

3. Titulli i gjetjes: Mungesë të burimeve njerëzore.
Situata: Nga auditimi u konstatua se ISUV ka mungesë në burimeve njerëzore.
Struktura aktuale e funksionimit të ISUV bëhet në zbatim tëUrdhrit nr. 126, datë 23.10.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV", e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave. ISUV ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 99 punonjësish. Aktualisht, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë 12 vende vakante, për të cilat institucioni duhet të ndërmarrë masa për ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.

Kriteri: Urdhri nr. 126, datë 23.10.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV".
Ndikimi/efekti: Risk në mos përmbushje të objektivave institucinale të përcaktuara.
Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për miremenaxhimin e burimeve njerëzore.
Rëndësia: E lartë
3.1 Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për plotësimin e kapaciteteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.

4. Titulli i gjetjes:ISUV nuk ka menaxhuar zhvillimin e burimeve njerëzore.
Situata: Nga auditimi u konstatua se Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në strukturën e tij, ka vetëm një specialist TI, i cili është në varësi të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe përshkrimi i tij i punës bëhet sipas rregullave në fuqi të DAP.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka identifikuar nevojat, nuk ka hartuar një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Trajnimet që punonjësit kryejnë nga ASPA nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e stafit për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
Ndikimi/efekti: Risk për moszbatimin e objektivave të përcaktuara.
Shkaku: Mos marrja e masave nga niveli menaxherial për mirëmenaxhimin e strukturave organizative dhe burimeve njerëzore.
Rëndësia: E lartë
4.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të ndërmarrë masa për identifikimin e nevojave për specialist TI dhe ngritjen e një strukture TI duke bërë gjithashtu edhe identifikimine nevojave për trajnim, hartimine planeve të trajnimeve dhe kryerjes së tyre.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimine funksionimit të Qeverisjes TIK në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë mbajnë përgjegjësi: z. A.R. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, znj. B.Ç. në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse.

III. 2.2. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a. Zhvillimi i procedurave në lidhje me TIK dhe marrëveshjet në nivel shërbimi

-Procedurat e investimeve në fushën TIK.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë bazuar në Regjistrin e Realizimeve, vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, përgjatë vitit 2020 ka realizuar 7 procedura prokurimi dhe gjatë vitit 2021 ka realizuar 5 procedura prokurimi me bazë Teknologjinë e Informacionit. Procedura të tipit "Blerje e Vogël" kryesisht me fond limit deri ne 100,000 lekë. Investimet janë kryer si pasojë e kërkesave të Specialistes së IT në ISUV, si më poshtë:

	Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Tipi i procedurës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Vlera e kontratës pa TVSH	Data e zhvillimit të procedurës se prokurimit
2020	1	Blerje materiale kompjuterike	100,000	Blerje e vogël	I. O.	100,000	6/23/2020
	2	Riparim i serverit qendror ne ISUV	100,000	Blerje e vogël	A.	99,750	4/22/2020
	3	Shërbim interneti	100,000	Blerje e vogël	P. Shpk	48,000	16/03/2020
	4	Shërbim interneti për ISUV viti 2020	700,000	Blerje e vogël	A. Shpk	499,000	4.29.2020
	5	Shërbim për monitorimin e mediave	800,000	Blerje e vogël	M.	785,000	04.02.2020
	5	Shërbim marrëdhënie me publikun, mirëmbajtje të faqes zyrtare të ISUV 2020	800,000	Blerje e vogël	A.	792,000	24/042020
	6	Riparim i sistemit të kamerave ne ISUV	100,000	Blerje e vogël	A.	99,200	4/27/2020
	7	Servis riparim printerash	100,000	Blerje e vogël	A	99,000	5/4/2020
	8	Shërbim interneti për ISUV viti 2021	700,000	Blerje e vogël	K. Sh.p.k	695,000	02.01.2021
2021	9	Servis riparim printerash	100,000	Blerje e vogël	N	99,600	5/4/2021
	10	Riparim i serverit	100,000	Blerje e vogël	A	99,500	5/4/2021

		qendror ne ISUV					
		Shërbim për monitorimin e mediave	800,000	Blerje e vogël	M.	785,000	25/03.2021
	11	Shërbim marrëdhënie me publikun, mirëmbajtje të faqes zyrtare të ISUV 2021	800,000	Blerje e vogël	A.	792,000	3/30/2021
	12	Riparim i sistemit të kamerave ne ISUV	100,000	Blerje e vogël	N.	99,200	5/4/2021

Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga auditimi i procedurave të tipit "Blerje e Vogël" u konstatuan:

1. Titulli i gjetjes: Mungesë dokumentacioni në të gjitha procedurat me vlerë të vogël nën 100,000 lekë.
Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit " Blerje e Vogël" me vlerë nën 100.000 lekë u konstatua se procedurat janë zhvilluar pa hartuar procesverbalet sipas formularit nr. 5 të Udhëzim nr. 3, datë 27.01.2015.
Ndikimi/Efekti: Risk në vlerësim në mënyrë jo të duhur të Operatorëve Ekonomik.
Shkaku: Mos zbatim i procedurave.
Kriteri: Udhëzim Nr. 3, datë 27.01.2015. "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël, me vlerë nën 100.000 lekë**.**
Rëndësia: E mesme
1.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në zhvillimin e procedurave "Blerje e Vogël" me vlerë nën 100.000 lekë të hartojë procesverbalet përkatëse.

2. Titulli i gjetjes: Mungesë e Specifikimeve Teknike në Kontratë për shërbimet që janë kryer.
Situata: Nga auditimi i procedurave të prokurimit: "Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2020" dhe "Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2021" u konstatua se nuk janë përcaktuar specifikimet teknike për shërbimet që do të kryhen.
Ndikimi/Efekti:Vështirësi në monitorimin dh e zbatimin e kontratave.
Shkaku: Mos zbatimi i përcaktimeve ligjore mbi prokurimet publike.
Kriteri: Neni 28, pika i Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr. 823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016.
Rëndësia: E lartë
2.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen në procedurat që do të kryej duhet të marrë masa që në termat e referencës, të përfshihet objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

3. Titulli i gjetjes: Mungon një situacion që të përcaktojë vlerën e shërbimeve të ndryshme që kryhen.
Situata: Nga auditimi i procedurës se prokurimit "Shërbim Marrëdhënie me publikun 2020" u konstatua se nuk ka një situacion që të përcaktoj vlerën e secilit shërbim që kryhet duke qenë se shërbimet janë të ndryshme, si më poshtë:

- Shërbime për marrëdhëniet me publikun dhe mediat si dhe përditësimin e faqes së internetit dhe mediave sociale;
- Shkrim artikujsh dhe botim të tyre ne media, organizim konference për shtyp;
- Shërbime të marrëdhënieve me Publikun, organizim vizitash (study tour) me nxënës, studente dhe grupime të tjera për t'u njohur me ISUV;
- Përmirësim e website www.isuv.gov.al;
- Plotësim i website me përmbajtje, artikuj, foto etj;
- Rankim i faqes ne Google, përdorimi i teknikave SEO;
- Ngritje e profileve Social Media (Facebook, Youtube etj) sistemim i informacionit dhe menaxhim i përditshëm i këtyre kanaleve sociale të komunikimit.

Ndikimi/Efekti: Vlerësim i gabuar dhe mungesë transparence e shërbimeve që kryhen.
Shkaku: Mos plotësim i kushteve kontraktuale.
Kriteri: Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve të NJSP.
Rëndësia: E mesme
3.1. Rekomandim: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duhet ti kërkojë kontraktuesit së bashku me raportet mujore dhe situacionin e shërbimeve të kryera**.**

4. Titulli i gjetjes: Asnjë nga anëtaret e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nuk është specialist në fushën e Teknologjisë së Informacionit.
Situata: Nga auditimi i procedurës se prokurimit "Shërbim internet për Instucionin për vitet 2020 dhe 2021" u konstatua se pas verifikimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit u konstatua se, në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave asnjë nga anëtarët nuk është specialist i fushës, konkretisht:
Znj.B.Ç.
Znj.A.I.
Znj.F.H.
Ndikimi/Efekti: Vlerësim në mënyrë jo të duhur të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.
Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit mbi Prokurimet Publike.
Kriteri: Neni 57 & 58 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 *"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar me Vendimin nr. 402, datë 13.05.2015, me Vendimin nr. 823, datë 23.11.2016, me Vendimin nr. 797, datë 29.12.2017 dhe me Vendimin nr. 80 datë 14.2.2018.
Rëndësia: E lartë
4.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimit të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e blerjes së Teknologjisë së Informacionit mbajnë përgjegjësi: z.A.R.në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, znj. B.Ç.në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, znj. E.K. në cilësinë e Specialistes IT, znj. A.I. në cilësinë e Juristes dhe znj. F.H. në cilësinë e llogaritares.

- Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (ServiceLevelAgreement).

Gjatë periudhës objekt auditimi, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është kryer zbatimi i një kontrate "*Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit*".

Nr.	Objekti i Prokurimit Viti 2020-2021	Fondi Limit	Lloji i Procedurës se Prokurimit	Vlera e kontratës	Data e zhvillimit të procedurës se prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes se kontratës	Data e përfundimt kontratës
1	Mirëmbajta e sistemit LIMS	7,860,120	Kërkesë për propozim	7,644,000	20.06.2015	A.	27.11.2019	26.11.2021

Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë përpunuar nga grupi i auditimit.*

Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit" me objekt: "Mirëmbajtje e sistemit Lims"

-Për periudhën objekt auditimi në subjektin e audituar**:** "Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë", është në proces zbatimi kontrata "Marrëveshje e Nivelit të Shërbimit" sipas Kontratës nr. Prot 7364, datë 27.11.2019 me objekt "**Mirëmbajtje e sistemit Lims**", të lidhur mes palëve Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (Autoriteti Kontraktor) dhe Kontraktuesi "A. sh.p.k". Përfituesi i shërbimit është: "Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë". *Në zbatim të pikës II, nënpika i,të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.673 datë 22.11.2017. " Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" i ndryshuar, AKSHI si organi që: Organizon, kryen prokurimet e qendërzuara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet softuerë dhe harduerë, mirëmbajtjen si dhe shërbimet e internetit dhe intranetit me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla.*

Vlera e kontratës është 7,644,000 (shtatë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzetë) lekë pa TVSH ose 9,172,800 (nëntë milion e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë me TVSH, shumë e cila paguhet nga Autoriteti përfitues (ISUV). Kohëzgjatja e parashikuar në kontratë është 24 muaj shërbim. Lloji i procedurës: "Kërkesë për propozim".

Mbi zbatimin e kontratës ***"Mirëmbajtje e sistemit Lims"*** u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Njoftim për Zbatim kontrate nga AKSHI, datë 04.12.2019;
- Urdhri i Prokurimit;
- Kontrata e shërbimit datë 27.111.2019;
- Formulari i Sigurimit të Kontratës;
- Specifikimet Teknike;
- Raportet e monitorimit;
- Urdhër i brendshëm për marrje në dorëzim të shërbimit datë 02.12.2019;
- Situacioni i mirëmbajtjes datë 02.12.2019;
- Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit datë 02.12.2019;
- Faturat tatimore të likuidimit të vlerave mujore për shërbimin e kryer.

5. . Titulli gjetjes: Nuk janë implementuar 7(shtatë) komponentë të përshkuara në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit LIMSPër të cilat nga autoriteti kontraktor ka kryer pagesa sipas situacionit dhe faturave të paraqitura nga Operatori Ekonomik (A. Shpk).

Situata: Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit "Mirëmbajtjen e sistemit LIMS", grupi auditimit analizoi komponentët e përshkruar në raportet e mirëmbajtjes mbi operimin e këtyre komponentëve onsite në sistem.

Nga auditimi onsite në sistem u konstatua se nga 13 komponentë në totaltë përshkuara dhe kërkuara në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit LIMS**,** 7(shtatë) prej këtyre komponentëve **n**uk janë të implementuara. Për këto komponentë Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa sipas raporteve dhe faturave të paraqitura nga Kontraktori (OE) (A. Shpk), me vlerën 1,704,000 Lekë., vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit.

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik në buxhetin e Shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i procedurave të marrjes në dorëzim të shërbimit të kryer.

Kriteri: Dokumentet standarde të tenderit.

Rëndësia: E lartë

5.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.

Situacioni i mirëmbajtës i sistemit "Lims",Komponentët që duhet të ishin pjesë e sistemit

Nr.	Përshkrimi Punës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	TVSH	Vlera me TVSH
Departamenti Shëndetit të Kafshëve							
1	Kontroll Raporte Tabelës dhe Grafikë. Mundëson gjenerimin e raporteve në interval kohore të zgjedhura në formë tabelore dhe grafike	copë	1.00	185,000	185,000	37,000	222,000
2	Kontroll Raporte Total kampionësh të mbërritura në Laborator	copë	1.00	135,000	135,000	27,000	162,000
3	Kontrolli Raporte Total kampionësh të mbërritura për qëllim Kampionimim Mundëson gjenerimin e raporteve për numrin kampioneve të ardhura për secilin nga qëllimet e kampionimit	copë	1.00	292,000	292,000	58,400	350,400
4	Kontroll Raporte informuese në faqen kryesore. Mundëson gjenerimin e raporteve përgjithësuese, për kampionet që kanë ardhur dhe për se janë testuar	copë	1.00	382,500	382,500	76,500	459,000
5	Kontrolli Raporte Raste Alert.Mundëson gjenerimin e raporteve për rastet alert.	copë	1.00	227,500	227,500.	45,500	273,000
6	Kontroll Barkodi Gjenerator. Gjeneronbarkod në një format të parapacaktuar gati për printim	copë	1.00	242,000	242,000	48,400	290,400
Departamenti i Sigurisë Ushqimore							
7	Kontroll Eksportim të dhënash. Mundëson eksportimin e të dhënave në Excel	copë	1.00	240,000	240,000	48,000	288,000
Totali me TVSH		**Lekë**	**1,704,000**			**340,800**	**2,044,800**

Pretendimi i subjekti: Në lidhje me këtë pikë, gjatë takimit ballafaquesnë KLSH në datën 10.12.2021 u kërkua nga përfaqësuesit e subjektit, një verifikim nga grupi i auditimit, pasi pretendonin se këto komponentë ekzistonin dhe ishin tëimplementuara nga Kontraktori.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Subjekti i audituar për të argumentuar implementimin e komponentëve të istemit, gjatë takimit ballafaques paraqiti argumente të reja mbi ekzistencën e tyre. Nisur sa më sipër dhe në dakordesi me të gjitha palët grupi i auditimi verifikoi on site komponentët e Sistemit.
Pas verifikimit onsite mbi implementimin e komponentëve të sistemit dhe Logeve të sistemit të marra në rrugë elektronike, që subjekti paraqiti si fakte të reja për të argumentuar implementim e komponentëve të sistemit, grupi i auditimit mori pjesërisht në konsideratë observacionin për implementimin e 6 komponentëve dhe mban të njëjtin qëndrim për 7 komponentët e pa implementuar.
Grupi i auditimit nuk merr në konsideratë loget e paraqitura nga subjekti për të argumentuar pretendimin pasi ato nuk përfaqësojnë auditlogs të gjeneruara nga databaza.
Nisur sa më sipër, argumentet e parashtruara merren pjesërisht në konsideratë dhe ndryshimet përkatëse janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

6.Titulli Gjetjes:ISUVnuk ka nënshkruar marrëveshjetë nivelit të shërbimit me AKSHI-n, për shërbimet TIK që ofrohen nga ky i fundit.
Situata: Nga auditimi u konstatua seniveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kryhen në mungesë të një marrëveshje midis

palëve, kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*".
Ndikimi/Efekti: Risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të AKSHI-t në ISUV.
Shkaku: Mungesae një marrëveshje nivel shërbimi midis ISUV dhe AKSHI-t.
Kriteri:VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*".
Rëndësia:E lartë
6.1. Rekomandim: ISUV në bashkëpunim me MBZHR t'i kërkojnë AKSHI-t lidhjen e një marrëveshje nivel shërbimi, për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve që AKSHI kryen ndaj ISUV.

7. Titulli Gjetjes: Parapagimi në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit Lims përtej kufijve ligjor.
Situata: Nga auditimi u konstatua se në nenin 9 tëkontratës së mirëmbajtjes sistemit LIMS është përcaktuar një shumë prej 4,000,000 lekësh (pa TVSH) që Autoriteti Kontraktor duhet ti parapaguaj Operatorit Ekonomik. Shuma e parapagimit i është bashkangjitur situacionit të mirëmbajtës. Parapagimi është në kundërshtim me udhëzimin nr. 9 datë 20.07.2018 për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit në të cilin thuhet se: Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor. Në këto raste paradhënia mund të jetë deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. Struktura përgjegjëse për thesarin evidenton vlerën totale të çdo kontratë/urdhër prokurimi, si dhe grafikun e shlyerjes së kontratës, pasi vërtetohet ekzistenca e fondeve buxhetore vjetore të mjaftueshme në SIFQ, për pjesën e vitit korrent të kontratës, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit në strukturën përkatëse buxhetore. Vlera e mbetur e kontratës shumëvjeçare regjistrohet për vitet pasardhëse.
Ndikimi/Efekti: Risk në mos kryerjen e shërbimeve të parashikuara.
Shkaku: Mos zbatim i legjislacionit mbi Prokurimet Publike.
Kriteri: Udhëzimi nr. 9 datë 20.07.2018 për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit i Ligjit nr. 9936, Datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor Në Republikën e Shqipërisë.
Rëndësia: E lartë
7.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të bazohen në përcaktimet e kornizave ligjore.

8. Titulli i gjetjes: Mbi Procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit ka rezultuar se asnjë prej personave në Komisionin e marrjes në dorëzim nuk është ekspert i fushës së Teknologjisë së Informacionit.
Situata:Në datën 02.12.2019 është mbajtur procesverbali mbi kryerjen e shërbimit "Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019" me kompaninë A. Sh.p.k. Sipas urdhrit të brendshëm Nr.120 datë 02.12.2019 është ngritur komisioni i cili do të vlerësojë dhe të marri në dorëzim shërbimin e përfshirë në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtjen e sistemit LIMS".Komisioni është i përberë nga: A.D. (Mjeke Veterinare); P.K. (Specialist Veterinar); H.M. (Specialist Mikrobiologjie).
Ndikimi/Efekti: Vlerësim në mënyrë jo të duhur të shërbimeve që do të kryhen.
Shkaku: Mos zbatimi i Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011.
Kriteri: Pika 43 e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve të NJSP.
Rëndësia: E lartë

8.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimit të Njësive të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative për përfshirjen e një specialist të fushës përkatëse.

9. Titulli i gjetjes: Raportet mujore që Kontraktuesi i paraqet Institucionit nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të Kontratës së mirëmbajtjes së sistemit.
Situata: Nga auditimi mbi plotësimin e kërkesave kontraktuale mbi mirëmbajtjen e sistemit "LIMS"u konstatua se raportet mujore nuk japin informacion mbi punën e kryer, por japin një konfirmim me "OK" që komponentët e sistemit janë funksional dhe kontrollet janë kryer, siç është kërkuar nëspecifikimet Teknike Specifikimeve Teknike të pacaktuara në Nenin 8, pika 3 të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit "Lims".
Kompania duhet të kryej:

- Raporte mbi shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese duke u bazuar mbi alertet;
- Raporte mbi alarme madhore dhe përgjigja ndaj tyre;
- Raporte mbi veprimtaritë e diagnostikimit dhe riparimit si kontrolli i logeve të serverit, kontrolli i storage dhe disqeve përkatëse;
- Vlerësimi i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për mirëmbajtjen infrastrukturës, pa përjashtuar edhe sugjerimet në adresë të infrastrukturës.

Ndikimi/Efekti: Risk në mos kryerjen e shërbimeve sipas specifikimeve teknike dhe mungesë transparencë.
Shkaku: Mos zbatimi i përcaktimeve kontraktuale.
Kriteri: Neni 8, pika 3 të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit "Lims".
Rëndësia: E lartë
9.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë procedurat ligjore dhe kontraktuale të marrjes në dorëzim të shërbimeve.

10. Titulli i gjetjes: Nuk ka një urdhër të brendshëm të titullarit për ndërrim punonjësi për marrjen në dorëzim të mirëmbajtjes të sistemit LIMS.
Situata: Në datën 02.12.2019 është mbajtur procesverbali mbi kryerjen e shërbimit "Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019" me kompaninë A. sh.p.k. Sipas urdhrit të brendshëm Nr.120 datë 02.12.2019 është ngritur komisioni i cili do të vlerësojë dhe të marri në dorëzim shërbimin e përfshirë në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtjen e sistemit LIMS". Nga shqyrtimi i dokumentacionit grupi i auditimit vuri re se një prej punonjësve (J.B.,Mjeke veterinare) ka firmosur procesverbalin, pa një urdhër të titullarit në vend të (A.D.,Mjeke Veterinare) e cila ishte një prej anëtarëve të grupit të marrjes në dorëzim të sistemit.
Ndikimi/Efekti: Risk në mos kryerjen e shërbimeve sipas specifikimeve teknike dhe situacionit të shërbimeve të paraqitur nga Kontraktuesi.
Shkaku: Mos zbatimi i përcaktimeve ligjore.
Kriteri: Pika 42 e Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 Menaxhimin i Aktiveve te NJSP.
Rëndësia: E lartë
10.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë të gjitha kornizat ligjore në delegimin dhe ndarjen e përgjegjësive.

Për sa është konstatuar më lart ,mbi auditimin e marrëveshjeve të nivel shërbimit dhe blerjes së Teknologjisë së informacionit Për miratimin e pagesës së faturës Z-137 datë 02.12.2019 me nr. serial 80263877 për punime të pakryera, për vlerën 1,704,000 lekë pa tvsh mbi zbatimin e kontratës "Mirëmbajtje e sistemit Lims" mbajnë përgjegjësi: z. A.R. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, znj. J.B. në cilësinë e Zëvendëstitullares, z. P.K. në cilësinë e Specialist Veterinar, z. H.M. në cilësinë e Specialistit të Mikrobiologjisë.

III. 2.3. Siguria e Informacionit

a. Mekanizmat, identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Objektivat e auditimit: Elementet kryesorë që do të auditohen janë: Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve te cilët funksionojnë së bashku në mënyrë që të bëjnë përpunimin dhe ruajtjen e informacionit për arritjen e objektivave të institucionit dhe funksionet e tij.
Siguria e informacionit ka një rëndësi të veçantë për institucionet, kjo për shkak të rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave në marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private, si dhe përdorimi i përbashkët i burimeve të informacionit.
Monitorimi dhe kontrolli i riskut është procesi i identifikimit, analizimit dhe planifikimit mbi zbulimin e rreziqeve të reja të identifikuara, monitorimit të rreziqeve të identifikuara më parë si dhe vlerësimit të rreziqeve ekzistuese për verifikimin e strategjive të reagimit ndaj rreziqeve të planifikuara mbi efektivitetin e tyre.
Për sa më sipër, institucionet publike të cilat ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve e kanë të detyrueshme ndërtimin e një programi sigurie me elementët kyç të cilët janë: "Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI".

-Testimi i Webpage të ISUV për dobësi:
Mbi performancën e faqes web të institucionit u bënë disa pen-test si dhe disa teste të thyerjes së sigurisë dhe dobësive të saj. Kjo është një metodë e cila përdoret për gjetjen e gabimeve dhe rreziqeve të jashtme të cilat mund të çojnë në bllokimin e faqes.
Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se:



Figura.nr.1
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.*
Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë paraqitur në Fig. nr.1, (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) që tregon se ndërveprimi i web browser-it dhe serverit bëhet duke përdorur protokollin HTTP, që indikon se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit i cili merret ose jepet përmes këtij portali. Po ashtu, një sulmues i jashtëm, i cili mund të akesojë në rrjet, do ti jepej mundësia të lexojë si dhe të ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, ku përfshihen (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive). Në rastin e një sulmi të jashtëm, i software-ve dhe versioni i përdorur, mundëson lehtësisht identifikimin dhe mund të përdoren për sulme specifike. Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të mungesës së HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), web siti ekspozon përdoruesit tek sulmuesit e XSS.

Figura nr.2.

Burimi: *Grupi i auditimit*.

Në total u konstatuan 15 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut paraqitur në Fig. nr. 2:- 1 prej tyre ka risk të lartë. Disa implementime HTTP/2 janë të cenueshme, duke sjellë bllokim të shërbimit, pasi sulmuesit kërkojnë një pjesë të madhe të të dhënave nga një burim i specifikuar mbi rrjedha të shumta. Ata manipulojnë madhësinë e dritares dhe prioritetin e transmetimit për të detyruar serverin radhisë të dhënat në pjesë "1- byte" shkakton mbingarkesë të konsiderueshme në funksionimin e CPU-së, memories ose të dyja.

- 3 kanë risk mesatar. Disa implementime HTTP/2 janë të cenueshme duke sjell bllokimin e shërbimit. Sulmuesit krijojnë rryma të shumëfishta kërkesash dhe vazhdimisht ndërron prioritetin e rrjedhës në një mënyrë që shkakton mbingarkesë në CPU.
- 6 kanë risk mesatar. Web serveri NGINX i ISUV ka versionin 1.14.1. Versionet e mëparshme deri tek versioni 1.17.7 i NGINX kanë disa konfigurime me error_page, gjë e cila lejon akses të pa autorizuar të kërkesave HTTP.
- Gjithashtu janë 5 risqe informacioni.

Këto dobësi i ekspozojnë aplikacionet e prekura ndaj rrezikut të qasjes së paautorizuar në të dhënat konfidenciale dhe rrit mundësinë e sulmeve.

- Verifikimi i Active Directory

Në thelb Active Directory është një bazë të dhënash, i cili siguron një kontroll të centralizuar, nga ku regjistrohen të gjithë ndryshimet e fjalëkalimeve si dhe mund të shpërndahet në të gjithë botën. Po ashtu, edhe shërbimet e tipit email mund të vënë në përdorim Active Directory i cili ruan burimet si share folder dhe printerët. Active Directory përdoret nga administratorët e rrjetit edhe për ruajtjen dhe organizimin e objekteve në një rrjet (të tilla si përdoruesit, kompjuterët, pajisjet, etj).

Active Directory mban një memorie të centralizuar për emrat, përdoruesit dhe fjalëkalimet. Çdo ndryshim që bëhet në emrat e përdoruesve dhe ne fjalëkalime regjistrohen nga Active Directory dhe të gjithë kompjuterët, që janë pjesë e rrjetit do të kenë akses në këtë informacion.

Pa Active Directory, çdo kompjuter në rrjet ka bazën e të dhënave të veta të vogla, të emrave, të përdoruesve dhe fjalëkalimeve, siç është dhe situata në ISUV.

Grupi i auditimit konstatoi se, nga administrimi i dokumentacionit mbi parametrat e pajisjeve Server për menaxhimin e user-ave, pajisjeve si dhe aplikacioneve për një identifikim të qendërzuar dhe të sigurt mbi kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet, ISUV nuk ka ngritur Active Directory.

Me përdorimin e Active Directory, ISUV do të mund të përfitonte një performancë më të mirë të aplikacionit, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimeve që institucioni ofron si dhe krijimin dhe logimin e përdoruesve për marrjen e shërbimeve më anë të një identifikimi të vetëm "single sign in".

Përdoruesit mund të logohen në kompjuter, email, rrjet etj., me anë të domain controller për të pasur një identifikim të sigurt. Me krijimin e user-ave dhe konfigurimin e email-eve në mënyrë manuale si dhe duke ruajtur të dhënat e përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qendërzuar rrezikon të komprometohet siguria e infrastrukturës network në ISUV. Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh godinat e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe

Veterinarisë me njëra tjetrën u konstatuase përdoruesit e marrin shërbimin në një Switch si dhe konfigurimet në rrjet janë si administratorë.

-Verifikimi i dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.
Përsa i përket planit të vazhdueshmërisë së biznesit, auditimi është bazuar në VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit". Në bazë të kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me synimin për ofrimin e shërbimeve për qytetarët, biznesin si dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike me anë të këtyre sistemeve, do të duhet të parashikojë dhe të ndërmarrë masa mbi krijimin e një sistemi për vazhdueshmërinë e punës dhe të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të një shërbimi pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave.
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë bie në kundërshtim me këtë VKM, pasi është një institucion i cili ruan, përpunon dhe gjeneron të dhëna me një rëndësi të veçantë për analizimin në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve.
Nga auditimi u konstatua se ISUV, nuk rezulton të ketë dokumentim/implementim të planeve mbi sigurinë e informacionit. ISUV nuk rezulton të ketë dokumentacion përsa i përket planit të vazhdueshmërisë së punës (BCP), në rastet e dështimit të dhomës së serverëve e cila suporton sistemin LIMS.
Në këto dokumente përcaktohen masat, procedurat dhe objektivat mbi rivënien në funksion të sistemit në rastet e emergjencave të cilat sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.

-Nga auditimi i sigurisë së bazës së të dhënave të LIMS për periudhën 01 janar 2019 deri më 30 qershor 2021 rezulton se janë kryer veprime duke krijuar 951 "Hendeqe" në fushën ID. Ky rezultat tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimentale, si pasojë jep mundësinë për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe s'të jep mundësinë e ndjekjes së një rrjedhje historike të faturave që nga krijimi, modifikimin final ose dhe deri në fshirjen e tyre ose personat të cilët kanë akses në bazën e të dhënave kanë kryer sistemime apo fshirje të të dhënave duke gjeneruar ID me Hendeqe. Me fshirjen e të dhënave fshihet gjithashtu dhe gjurma e auditimit.

- Ambienti fizik i dhomave të serverëve
Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverëve, u krye referuar VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" dhe Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, në të cilën parashtrohen standardet e TIK për administratën publike. Dëmet e shkaktuara në dhomat e serverëve do të sillnin probleme serioze për funksionimin e sistemit në institucion.
Nga verifikimi i dhomave të serverëve në ISUV, grupi i auditimit konstatoi se ambientet fizike nuk janë në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), përkatësisht:
Ruajtja e pajisjeve fizike, kontrolli i aksesit fizike mbi pajisjet, kontrolli mbi personat që kanë akses fizik:
- Ambientet ku janë lokalizuar serverat e ISUV dhe network-u, kanë qenë zyra ekzistuese të cilat janë përshtatur për tu përdorur si dhoma serverësh;

- Pajisjet elektronike si serverat dhe pajisjet e rrjetit janë të ruajtura në këto hapësira, ku kanë akses vetëm specialistet e TI, nuk ka pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem intrusion detection kufizimin e personvet të paautorizuar;
- aksesi në ambientet e dhomave të serverëve nuk janë të kontrolluara me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj;
- Instalimi elektrik i dhomave të serverëve nuk është veçmas instalimit të përgjithshëm;
- Mungon sistemi i alarmit. Duhet të jenë të tillë që të sinjalizojnë problemet me rrymën elektrike, me ambientin fizik, sensor për rrjedhjen e ujit, sensor për parandalimin e dëmtimeve fizike të strukturës së dhomës.

Figura nr.3: Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dy dhomave të serverëve dhe aseteve të ndodhura në të (Paraqiten dy Rack me struktura fizike metalike dhe pjesët përbërëse të sistemit të pajisjeve elektronike dhe elektrike: server, switch, router, panele etj).

Figura nr.3
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.*

1. Titulli i gjetjes: ISUV nuk menaxhon risqet mbi teknologjinë e informacionit.
Situata: Nga auditimi mbi risqet lidhur me teknologjinë e informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë u konstatuase, nuk janë identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucional.
Për veprimet ose mosveprimet që janë në kundërshtim me nenin 11 pika 2 "Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik
arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.", 12 pika 3/d "Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë", nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të kishte hartuar regjistrin e riskut ku të përfshihen edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.
Kriteri: Neni 11, pika 2 "Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të

veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë.", 12 pika 3/d "Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë", nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015.
Neni 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 23.10.2015, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".
Ndikimi/efekti: Menaxhimin e user-ave, pajisjeve si dhe aplikacioneve për një identifikim të qendërzuar dhe të sigurt mbi kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.
Shkaku: Mungesa e kontrollit të qendërzuar të infrastrukturës network.
Rëndësia: E lartë
1.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut për teknologjinë e informacionit, në mënyrë që të analizohen dhe vlerësohen risqet dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre.

2. Titulli i gjetjes: Faqja web e ISUV nuk ka elemente të sigurisë për garantimin e navigimit të sigurt në të.
Situata: Nga auditimi i faqes web të ISUV është konstatuar se, portali nuk përdor një lidhje të sigurt, (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) që tregon se ndërveprimi i web browser-it dhe serverit bëhet duke përdorur protokollin HTTP, që tregon se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues. Në mungesë të kësaj certifikate mund të ndodhë humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit i cili merret ose jepet përmes këtij portali. Po ashtu, një sulmues i jashtëm, i cili mund të akesojë në rrjet, do ti jepej mundësia të lexojë si dhe të ndryshojë informacionin i cili aksesohet nga rrjeti, ku përfshihen (fjalëkalimet-et, të dhëna sekret si dhe të tjera të dhëna sensitive). Në rastin e një sulmi të jashtëm, i software-ve dhe versioni i përdorur, mundëson lehtësisht identifikimin dhe mund të përdoren për sulme specifike. Mbrojtësi X-XSS i HTTP dikton shfletuesin (browserin) të mos hap faqe webi të cilat kapin sulme Cross-Site Scripting (XSS) të reflektuar. Për shkak të mungesës së HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), web siti ekspozon përdoruesit tek sulmuesit e XSS. Në total u konstatuan 15 dobësi të faqes së webit, në 4 nivele të ndryshme të riskut.
Kriteri: Standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti: Humbje e privatësisë, ndryshimit të informacionit që shkëmbehet me anë të portalit.
Shkaku: Mungesa e certifikatës së sigurisë.
Rëndësia: E lartë
2.1 Rekomandimi: ISUV duhet të ndërmarrë masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë së navigimit online për të rritur sigurinë.

3. Titulli i gjetjes: ISUV nuk ka implementuar kontrolle të qendërzuar dhe rrezikon kompromettimin e sigurisë së infrastrukturës network.
Situata: Nga auditimi u konstatua se, nga administrimi i dokumentacionit mbi parametrat e pajisjeve Server për menaxhimin e user-ave, pajisjeve si dhe aplikacioneve për një identifikim të qendërzuar dhe të sigurt mbi kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet ISUV nuk ka ngritur Active Directory.

Me përdorimin e Active Directory, ISUV do të mund të përfitonte një performancë më të mirë të aplikacionit, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimeve që institucioni ofron si dhe krijimin dhe logimin e përdoruesve për marrjën e shërbimeve më anë të një identifikimi të vetëm "single sign in".
Përdoruesit mund të logohen në kompjuter, email, rrjet etj me anë të domain controller për të pasur një identifikim të sigurt. Me krijimin e user-ave dhe konfigurimin e email-eve në mënyrë manuale si dhe duke ruajtur të dhënat e përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qendërzuar rrezikon të komprometohet siguria e infrastrukturës network në ISUV. Nga auditimi i rrjetit kompjuterik që lidh godinat e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë me njëra tjetrën u konstatua se përdoruesit e marrin shërbimin në një Switch si dhe konfigurimet në rrjet janë si administratorë.
Kriteri: Standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti: Menaxhimin e user-ave, pajisjeve si dhe aplikacioneve për një identifikim të qendërzuar dhe të sigurt mbi kontrollin dhe menaxhimin e shërbimeve.
Shkaku: Mungesa e kontrollit të qendërzuar të infrastrukturës network.
Rëndësia: E lartë
3.1 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV nëpërmjet implementimit të Active Directory.

4. Titulli i gjetjes: ISUV nuk ka marrë masa për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës dhe të ruajtjes së informacionit.
Situata: Nga auditimi u konstatua se ISUV, nuk rezulton të ketë dokumentim/implementim të planeve mbi sigurinë e informacionit dhe dokumentacion përsa i përket planit të vazhdueshmërisë së punës (BCP), në kundërshtim me VKMnr. 710,datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"
Në këto dokumente përcaktohen masat, procedurat dhe objektivat mbi rivënien në funksion të sistemit në rastet e emergjencave të cilat sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes) dhe RPOs (Objektivat e Punës së Ripërtëritjes) për çdo proces kritik.
Kriteri: VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit".
Ndikimi/efekti: Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.
Shkaku: Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit.
Rëndësia: E lartë
4.1 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin, përditësimin dhe miratimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë planet për backup, sistemet dhe pajisjet kompjuterike.

5. Titulli i gjetjes: Në sistemin LIMS janë kryer sistemime jo të mbështetura në bazë rregullatore.
Situata: Nga auditimi mbi sigurinë e bazës së të dhënave të sistemit LIMS për periudhën 01.01.2019 deri më 30.06.2021 u konstatua se janë kryer veprime duke krijuar 951 "Hendeqe" në fushën ID. Ky konstatim tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e ID inkrimental rritës, si pasojë krijohet mundësia për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe nuk është e mundur ndjekjae rrjedhës historike tëdhënave të sistemit. Nisur sa më sipër personat të cilët kanë akses në bazën e të dhënave kanë kryer sistemime apo fshirje të të dhënave duke gjeneruar ID me Hendeqe, pa autorizim nga personat përgjegjës në ISUV.

Kriteri: Standardet ndëkombëtare dhe praktikat më të mira të fushës.
Ndikimi/efekti: Hendeqe ndërmjet të dhënave dhe humbje e gjurmës audituese.
Shkaku: Mos zbatim të rregullave në administrimin e programeve që administrojnë vlera monetare.
Rëndësia: E lartë
5.1 Rekomandimi: ISUV të marrë masa për analizimin e situatës së krijuar në lidhje me "Hendeqet" në fushën ID, duke hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.

6. Titulli i gjetjes: Dhomat e serverave nuk plotësojnë standardet e përcaktuara.
Situata: Nga auditimi u konstatua se ISUVnuk ka dhome serverësh, por janë 2 zyra të përshtatura si dhoma serverësh të cilat nuk plotësojnë standardet e përcaktuara sipas rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve miratuar nga AKSHI..
Kriteri: Rregullorja për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI.
Ndikimi/efekti: Cënimi i sigurisë, hyrje të paautorizuara dhe risku i humbjes së të dhënave.
Shkaku: Mos njohje e bazës rregullatore mbi standardet dhe sigurinë fizike të ambienteve të infrastrukturave kritike.
Rëndësia: E lartë
6.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverëve në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për sa është konstatuar më lart, mbi auditimin e Sigurisë së Informacionit, Mekanizmave, identifikimit dhe adresimi i risqeve në TIK,mbajnë përgjegjësi: z. A.R. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, znj. J.B. në cilësinë e Zëvendëstitullares, znj. B.Ç. në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, znj. E.K. në cilësinë e Specialistes TI.

III. 2.4.Auditimi i sistemeve

a. Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input/Output

Objektivi. Vlerësimi i kontrolleve të aplikacionit, për të dhënat Input/Output ka si qëllim të verifikojë kontrollet e implementuara në aplikacion si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të objektivave të institucionit.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në fokus të tij ka analizimin në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve dhe produkti jonë (Përgjigjja e detajuar e analizave me treguesit përkatës), pasqyrohet në Raportin e Provës që laboratori nxjerr për çdo kampion të analizuar.
Ecuria analitike e kampionaturës pasqyrohet në sistemin LIMS që nga momenti i mbërritjes në Zyrën e Pritjes së Kampioneve dhe deri në momentin e nxjerrjes së rezultatit në laborator. Këto raporte prove dhe të dhëna analitike që hidhen në sistem dhe nxirren në formën shkresore, jo vetëm që dokumentohen në institut por i dorëzohen dhe subjekteve të interesuar që kanë sjellë kampionaturën ku mund të jenë privat ose shtetërore dhe që shpesh herë përdoren për qëllime eksporti jashtë vendi.

Sa më sipër ky sistem shërben për mbajtjen e regjistrit të laboratorëve që operojnë nën mbikëqyrjen e ISUV dhe për regjistrimin e të gjithë ekzaminimeve që ato kryejnë. Sistemi përmbush të gjithë procesin e punës të një laboratori duke filluar nga regjistrimi i kampionëve dhe deri te rezultati i analizave. Sistemi nuk lejon që të regjistrohet një kampion në rast se nuk i përket një fermeri të regjistruar në sistemin e regjistrit kombëtar të veterinarisë. Në sistem përmes një shfletuesi web kanë akses vetëm përdorues të autorizuar nga ISUV.
Institucioni nuk ofron shërbime elektronike për publikun në sistemin LIMS, por përdoret vetëm nga punonjësit e ISUV.

-Databaza e sistemit LIMS ka strukturat si më poshtë:
a. Struktura e të dhënave mbi përdoruesit dhe rolet e tyre në sistem.
Në këtë strukturë janë të gjitha tabelat që kanë të bëjnë me përdoruesit e sistemit të brendshëm, kredencialet dhe rolet e tyre, që përcaktojnë edhe funksionalitetet që do ti shfaqen secilit përdorues.
b. Të dhënat mbi Sistemin LIMS. Ky sistem shërben për mbajtjen e regjistrit të laboratorëve që operojnë nën mbikëqyrjen e ISUV dhe për regjistrimin e të gjithë ekzaminimeve që ato kryejnë. Sistemi përmbush të gjithë procesin e punës të një laboratori duke filluar nga regjistrimi i kampionëve dhe deri te rezultati i analizave. Sistemi nuk lejon që të regjistrohet një kampion në rast se nuk i përket një fermeri të regjistruar në sistemin e regjistrit kombëtare të veterinarisë. Në sistem përmes një shfletuesi web kanë akses vetën përdorues të autorizuar nga ISUV. Gjithashtu ne këtë strukturë të dhënash përfshihen edhe tabelat e konfigurimeve të sistemit dhe të dhënave të referencës.

Menutë kryesore të sistemit janë:

1. Shëndetin e Kafshëve
2. Sigurinë Ushqimore

- **Stafi -** në këtë seksion konfigurohet user-at dhe roli i tij që do të ketë
- **Financa -** bën kalimin e pagesës së formularit të pranimit që Subjekti kryen.
- **Anullime -** bën anullimin e formularëve të pranimit dhe fletëve të punës së laboratorit të cilët i kemi përfunduar

- **Shëndeti i Kafshëve**
- **Shërbime** plotësohen llojet e provave / shërbimeve që nevojiten për analizimin e Kampionëve të cilat mund të realizohen
    - *Prova,*
    - *Metoda,*
    - *Kritere Teknike,*
    - *Tipet e Kampioneve*
- **Konfigurime -** ndërfaqe kemi plotësimin e Subjekteve dhe Kampionuesëve nga merren Kampionët për tu analizuar.
    - *Subjekte,*
    - *Kampionues,*
    - *Transportues,*
    - *Veterinerë zyrtar*
- **Regjistra -** kemi plotësimin e të dhënave për Formularin e Pranimit deri tek kampione të refuzuara.
    - *Formular Shoqërimi - bën plotësimin e të dhënave në lidhje me kampionin. Çdo formular ka kodin e vet unik i cili e identifikon nga formularët e tjerë*
    - *Formular Pranimi - merret me plotësimin e të dhënave që vjen nga Formulari Shoqërimit pasi ai të publikohet*
    - *Raporte Prove - shfaq raportin përfundimtar të kampionit, që përfshin të dhënat e tij në mbërritje e deri te analizat e aplikuara mbi të dhe rezultatet e nxjerra nga laboratori*
    - *Kampione të Refuzuara - shfaq kampionet që janë refuzuar dhe arsyet pse ata janë refuzuar.*
- **Laboratorë -** / përfshin të gjithë laboratorët që ka departament

- **Siguria Ushqimore**
- **Shërbime -** llojet e provave / shërbimeve që nevojiten për analizimin e Kampionëve të cilat mund të realizohen.
    - *Prova,* - plotësohet se në cilin laboratorë dërgohet dhe specilistin që do marrë përsipër analizimin e matricës. Kohëzgjatjen e saj nëse kryhet apo jo, dhe metodën që do të kryhet.
    - *Kategori Matrice & Matrica,* - emërtohet dhe regjistrohet matrica
    - *Kritere Teknike,* - plotësohen të dhënat që nevojiten për kriteret e matricës në dorëzim
    - *Prova e Jashtme* - prova që kërkon klienti dhe i shfaqet ZPK për ta zgjedhur te formulari i pranimit dhe merret në përgjegjësi të laboratorit përkatës dhe provës së brendshme që analizon.
- **Konfigurime -** kemi plotësimin e Subjekteve dhe Kampionuesëve nga merren Matricat për tu analizuar
- **Regjistra -** kemi plotësimin e të dhënave për Formularin e Pranimit dhe Raporte Prove.
    - *Formular Pranimi - bën plotësimin e të dhënave në lidhje me matricën. Çdo formular ka kodin e vet unik i cili e identifikon nga formularët e tjerë*
    - *Raporte Prove - shfaq raportin përfundimtar të kampionit, që përfshin të dhënat e tij në mbërritje e deri te analizat e aplikuara mbi të dhe rezultatet e nxjerra nga laboratori*

- **Laboratorë** - shfaq / përfshin të gjithë laboratorët që ka departamenti. Në secilin laboratorë dërgohen kampionët për tu analizuar.

Input. Të dhëna hyrëse në këtë sistem janë:

- Data dhe koha e marrjes së mostrës;
- Arsyeja;
- Numri dhe madhësia e mostrës finale;
- Lloji i ngarkesës/partisë së mallit (me shumicë/e paketuar);
- Numri dhe lloji i paketave të ngarkesës/partisë së mallit;
- Sasia e ngarkesës/partisë së mallit;
- Procedura e përdorur për marrjen e mostrës;
- Pajisjet marrëse ndihmëse;
- Kushtet ambientale në momentin e marrjes së mostrës
- Kushtet e magazinimit/ruajtjes dhe transportit;
- Masat paraprake për sigurinë;
- Vulat, shenjat/shënimet dhe numrat e tyre;

Detajet e deklaruesit (Emri, adresa numri i regjistrimit); etj;

- Nga analizimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se, tek menuja Regjistra-Nën menuja Formularë Shoqërimi- qeliza KODI (përveç të dhënave numerike që duhet të marrë dhe duhet të ishte standarde) kjo fushë merr karaktere të tjera si shkronja "e", shenjat e pikësimit pikë "." dhe presje ",".
- Nga analizimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se, në menunë "Subjekti që ka kërkuar provën", përveç emrave të personave apo subjekteve të cilët sjellin provat për t'u kryer analizat, në këtë fushë dalin dhe numrat "147,148, 89" dhe karakteri vizë "-".
- Nga analizimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se, tek fusha "Mënyra e kampionimit" lejon të shkruhen numra dhe karaktere, ndërkohë që duhet të jetë e parapërcaktuar si fushë, pasi janë vetëm 3 mënyra kampionimi "*1. e rastësishme, 2. me zgjedhje, 3. me gjueti.*"

Përsa më sipër, është paraqitur figura nr. 1 në të cilën pasqyrohen gabimet: në qelizën KODI, menunë "Subjekti që ka kërkuar provën" dhe fusha "Mënyra e kampionimit".



Fig.1 Analizimi i Inputit

Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

-Në analizimi i databazës së ISUV, nga 659 veterinerë të regjistruar, 507 prej tyre janë aktiv. Nga 507 veterinerë aktiv rezulton se 392 ose 77% prej tyre nuk kanë të regjistruar në sistem numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit.

Vetëm 115 ose 23% e veterinerëve kanë të dhëna të plota në databazën e LIMS.
Më poshtë në Grafikun nr.1 është pasqyruar informacioni mbi veterinerët të cilët nuk kanë të dhëna në sistem në raport me veterinerët që kanë të dhëna në sistem.



Grafiku 1. Të dhënat ku paraqiten veterinerët pa nr. telefoni dhe e-mail.
Burimi: *Grupi i auditimit*

-Nga analizimi i të dhënave në databazën e LIMS u konstatua se, fusha Work Postion, ka disa qeliza që duhet të kenë përshkrimin e punës, por janë bosh siç ilustrohet dhe në tabelën nr. 1. Edhe pse janë pa përshkrim pune, këto pozicione pune janë aktive dhe kanë numër telefoni, siç është e ilustruar më poshtë në tabelën nr. 1.

user_id	Work_position	deleted	phone
13	--	FALSE	
43	-	FALSE	6
42	-	FALSE	3
17	-	FALSE	
48	-	FALSE	6

Tabela Nr.1. Pozicionet e punës pa përshkim.
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

-Nga analizimi i të dhënave në databazën e LIMS u konstatua se, nga 58 pozicione pune për të cilët janë paraqitur të dhënat, 15 prej tyre nuk kanë numër telefoni në sistem, siç është e ilustruar më poshtë në tabelën nr. 2.

user_id	Work_position	deleted	phone
14	Kreu i Departamentit tĂ« ShĂ«ndetit tĂ« KafshĂ«ve	FALSE	
21	admin siguria ushqimore	FALSE	
19	Specialist Zooteknik	FALSE	
46	Finance	FALSE	
47	PĂ«rgj.Sektori, Ref.CilĂ«sie,		
49	Specialist Lab. Histamine, PAH-eve		

35	Specialist Lab. MMV		
58	Specialiste Lab. Kontrollit Pesticideve BimĂ«	FALSE	
23	Specialist Lab. Fitoplanktonit, Biotoksinave, PAH-eve		
26	PĂ«rgjegjĂ«s Sektori		
51	Specialist Lab. Analitik dhe Konservave		
10	Virolog,Biolog molekular	FALSE	
61	Kontroll	FALSE	

Tabela nr. 2. Pozicionet e punës pa numër telefoni.
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

-Nga analizimi i të dhënave në databazën e LIMS u konstatua se, përdoruesit me user: "*a.., s... dhe s...*" janë usera në të cilët nuk janë përcaktuar personat përgjegjës që i përdorin. Gjithashtu këta 3 usera kanë akses për kryer çdo lloj veprimi në databazë, siç është e ilustruar më poshtë në tabelën nr. 3:

last_login	superuser	username	First name	last_name	email
20..-0.-2.	t	s...	S...		
20..-0.-2.	t	s...			c...
20..-1.-0.	t	a...	S...	C...	c...

Tabela nr. 3. Userat a... pa limit aksesi mi.
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

-Nga analizimi i të dhënave në databazën e LIMS u konstatua se, punonjësja E.N. me user "e..." është larguar nga puna më datë 01.01.2021 por u konstatua se është loguar në sistem më 14.04.2021 ose katër muaj pasi është larguar nga puna. Ndërsa punonjësja B. K. me user "b..." ka marrë akseset e sistemit LIMS me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse, por nuk e ka përdorur asnjëherë sistemin, siç është e ilustruar më poshtë në tabelën nr. 4:

id	last_login	username	first_name	last_name	larguar më	Statusi
23	20..-0.-2.	m...	M .	B .	01.0..20..	jo aktiv
37	20..-0.-1.	e...	E.	N.	01.0..20..	jo aktiv
45		b...	B.	K.	31.1..20..	jo aktiv

Tabela nr. 4. Të larguarit nga puna dhe statusi në LIMS.
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

-Nga analizimi i të dhënave në databazën e LIMS u konstatua se punonjëset, S.B. me user "s." ka qenë pjesë e ISUV si studente ekselence dhe rezulton aktive përpara emërimit të saj në këtë institucion dhe M.B. me user "m." ka qenë pjesë e ISUV si praktikante nga Ministria e Arsimit dhe Mirëqenies Sociale. Kanë aplikuar në pozicionet përkatëse vakante dhe kanë fituar statusin e nëpunësit civil. Për këtë arsye aksesin në sistemin Lims e kanë pasur përpara emërimit si punonjës të ISUV.
Silvi Dhima me user "s." ka qenë pjesë e ISUV si praktikante nga Ministria e Arsimit dhe Mireqënies Sociale dhe është punësuar më datë 22.07.2020, por aksesi në sistemin Lims i është dhënë më datë 02.11.2021, siç është e ilustruar më poshtë në tabelën nr. 5.

id	last_login	date_joined	username	first_name	last_name	emruar me	Statusi
53	20..-..-06 ..:02:11	20..-..-14 ..:30:08	s.	S.	B.	13.0..20..	Aktiv
55	20..-..-11 ..:39:36	20..-..-16 ..:41:20	m.	M.	B.	08.0..20..	Aktiv
60	20..-..-10 ..:36:24	20..-..-03 ..:10:09	E.	E.	S.	01.06.2021	Aktiv
62	20..-..-10 ..:54:00	20..-..-02 ..:01:34	s.	S.	D.	22.0..20..	Aktiv

Tabela nr. 5. Punonjësit e emëruar dhe aksesimi në LIMS.
Burimi: *Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë. Përpunuar nga grupi i auditimit.*

- Nga analizimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se, punonjësit të cilët janë larguar, shfaqen në menunë Staf edhe pse janë të çaktivizuar. Gjithashtu të dhënat dhe veprimtaria e tyre ruhet edhe në databazën e LIMS.

1. Titulli i Gjetjes: Mungesë e masave organizative dhe teknike në lidhje me plotësinë dhe integritetin e të dhënave të sistemeve të teknologjisë së informacionit.
Situata: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se, tek menuja -Regjistra- Nën menuja Formularë Shoqërimi- qeliza KODI (përveç të dhënave numerike që duhet të marrë dhe duhet të ishte standarde) kjo fushë merr karaktere të tjera si shkronja "e", shenjat e pikësimit pikë "." dhe presje ",".
- Në menunë "Subjekti që ka kërkuar provën", përveç emrave të personave apo subjekteve të cilët sjellin provat për t'u kryer analizat, në këtë fushë dalin dhe numrat "1..,1.., 8." dhe karakteri vizë "-".
- Tek fusha "Mënyra e kampionimit" lejon të shkruhen numra dhe karaktere, ndërkohë që duhet të jetë e parapërcaktuar si fushë, pasi janë vetëm 3 mënyra kampionimi "*1. e r., 2. me z. 3. me g.*
- Nga 659 veterinerë të regjistruar, 507 prej tyre janë aktiv. Nga 507 veterinerë aktiv rezulton se 392 ose 77% prej tyre nuk kanë të regjistruar në sistem numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit.
Vetëm 115 ose 23% e veterinerëve kanë të dhëna të plota në databazën e LIMS.
- Nga 58 pozicione pune për të cilët janë paraqitur të dhënat, 15 prej tyre nuk kanë numër telefoni në sistem.
- Fusha Work Postion, ka disa qeliza që duhet të kenë përshkrimin e punës. Edhe pse janë pa përshkrim pune, këto pozicione pune me user ID përkatës: "..,..,..,..,.." janë aktive dhe kanë numër telefoni.
- Përdoruesit me user: "*a., s. dhe s.*" janë usera në të cilët nuk janë përcaktuar personat përgjegjës që i përdorin. Gjithashtu këta 3 usera kanë akses për kryer çdo lloj veprimi në databazë.
- Punonjësja Ederina Ninga me user "e." është larguar nga puna më datë 01.0..20.. por u konstatua se është loguar në sistem më 14.0..20.. ose katër muaj pasi është larguar nga puna. Ndërsa punonjësja B.K. me user "b."ka marrë akseset e sistemit LIMS me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse, por nuk e ka përdorur asnjëherë sistemin.
- Punonjësit të cilët janë larguar, shfaqen në menunë Staf edhe pse janë të çaktivizuar. Gjithashtu të dhënat dhe veprimtaria e tyre duhet të ruhen edhe pasi të largohen për një periudhë kohe sipas ligjit të dokumentit elektronik.
Kriteri: Ligji nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike"; Neni 27, Ligji Nr. 9887, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar; VKM Nr. 710, datë 21.08.2013 ''Për Krijimin dhe

Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit", i ndryshuar.
Ndikim/Efekti: Risk për mos-garantimin e plotësisë dhe integritetit të të dhënave të sistemeve
TI dhe humbje e gjurmës audituese.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.
Rëndësia: E lartë
1.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të LIMS duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.
1.2. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për plotësimin e sistemit LIMS të të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.
1.3. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.
1.4. Rekomandimi:ISUV të marrë masa që të mos shfaqen në ndërfaqen Web të LIMS, punonjësit e larguar nga puna ose punonjës të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës dhe i'u është hequr aksesi nga sistemi LIMS, por të ruhet veprimtaria e tyre në data bazë e sistemit.

2. Titulli i Gjetjes: Mungesa e gjenerimit të raporteve dhe mospërdorim i databazës së Sistemit LIMS.
Situata: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se:
- Ky sistem nuk të jep mundësinë e filtrimit dhe gjenerimit të raporteve.
-Nuk ka eksport për të dhënat (informacionet) jep vetëm total rekordesh.
Mungesa e gjenerimit të raporteve sjell pamundësinë e monitorimit të sistemit, mospërdorimin e data bazës për analizime statistikore dhe raportime javore ose mujore në varësi të nevojave të institucionit, si dhe mungesën e politik bërjes specifike sipas rajoneve, grupeve ushqimore, grup kafshësh, etj.
Kriteri: Kontrata nr. 7364 prot, datë. 27.11.2019.
Ndikim/Efekti: Sjell pamundësinë e monitorimit të sistemit, mospërdorimin e databazës për analizime statistikore dhe raportime javore ose mujore.
Shkaku: Mos plotësim nga ana e OE i Specifikimeve teknike dhe situacionit mbi të cilin është bërë edhe parapagesë.
Rëndësia: E lartë
2.1. Rekomandimi: ISUV të kërkojë tek OE përmbushjen e funksionaliteteve që mungojnë, për gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS.

3. Titulli i Gjetjes: Mangësi mbi menaxhimin e përdoruesve të sistemit LIMS.
Situata: Nga testimet dhe verifikimet që u zhvilluan mbi përdoruesit e sistemit LIMS u konstatuan disa problematika, konkretisht:
-U testua ndryshimi i fjalëkalimit, duke vendosur vetëm germa të vogla dhe u konstatua se u pranua si fjalëkalim, që bie në kundërshtim me nën pikën a.2. të Pikës 4. "Kërkesat e Sigurisë" në përputhje me *"Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe*

Sistemet Kompjuterike", miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), përkatësisht

Nënpika a.2. Fjalëkalimi duhet të përmbajë një kombinim të germave kapitale dhe të vogla, numrave dhe karaktereve special (si !, @, #, etj);

- Nga auditimi informacionit të vënë në dispozicion u konstatua se përdoruesit nuk e kanë ndryshuar fjalëkalimin çdo 90 ditë, që bie në kundërshtim me nën pikën a.3. të Pikës 4. "Kërkesat e Sigurisë" në përputhje me *"Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike",* miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), përkatësisht

Nënpika a.3. Fjalëkalimet duhet të ndryshojnë çdo 90 ditë. Në rast kompromentimi të fjalëkalimit ai duhet të ndryshohet menjëherë;

-Fjalëkalimet e përdoruesve nuk plotësojnë kërkesat e Sigurisë në përputhje me *"Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike",* miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), përkatësisht:

- Nga auditimi informacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, përdoruesit e rinj të sistemit LIMS e marrin fjalëkalimin me e-mail, nga personat përgjegjës. Edhe grupit të auditmi i'u komunikua me e-mail, që bie në kundërshtim me nën pikën a.5. të Pikës 4. "Kërkesat e Sigurisë" në përputhje me *"Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike",* miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), përkatësisht

Nënpika a.5. Fjalëkalimi nuk mund t'u komunikohet të tjerëve, të shkruhet në letër, ose të ruhet në ndonjë file ose bazë të dhënash në kompjuter;

Kriteri: Urdhri nr. 86, datë 23.08.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

Ndikim/Efekti: Risk për kompromettimin e të dhënave.

Shkaku: Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative.

Rëndësia: E lartë

3.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit LIMS ku të identifikohen qartë:

- rregullat e monitorimit;
- politikat e implementuara për fjalëkalimet e administrimitdhe përdoruesit fundor;
- të dhënat e detyrueshme që nevojiten të plotësohen për çdo përdorues;
- të dhënat e pandryshueshme për secilin prej tyre;
- ndalimin e krijimit të më shumë se një përdoruesi për punonjës;
- ndalimin e krijimit të një përdoruesi të ri për punonjësin ekzistues.

4. Titulli i Gjetjes:ISUV nuk ka ndërmarrë hapa të mëtejshme për ndërveprimin e databazës së saj me databazat e institucioneve të tjera.

Situata: Nga auditimi mbi aktet rregullative për dokumentimin dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave, rezulton se: ISUV nuk disponon asnjë akt rregullativ të brendshëm me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me Ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, për "*Bazat e të dhënave shtetërore*", neni 5.

Pavarësisht se databaza e sistemit lims është miratuar si databaze shtetërore ISUV nuk ka ndërmarrë hapa të mëtejshme për ndërveprimin e saj me databazat e institucioneve të tjera.

Kriteri: Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, për "Bazat e të dhënave shtetërore", konkretisht:

Neni 5: "*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*";
Ndikim/Efekti: Mungesë informacioni mbi mënyrën se si qarkullojnë të dhënat dhe ndërveprimin e tyre me palë të treta, mungesë organizimi dhe funksionimi për përdoruesit e të dhënave parësore apo dytësore.
Shkaku: Mungesa e strukturës së brendshme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave e sistemeve të informacionit, mos zbatim i ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për "*Bazat e të dhënave shtetërore*".
Rëndësia: E lartë
4.1. Rekomandimi: ISUV me qëllim rritje të efektivitetit të ndërsjellët të të dhënave që mbahen në sistemin LIMS në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MBZHR të identifikojnë fushat e ndërveprimit të databazës LIMS me databazat e institucioneve të tjera për arritjen e ndërveprimit në fushat e interesit reciprok.

5. Titulli i Gjetjes: Të dhënat administrohen nga OE që kryen mirëmbajtjen e sistemit, në mungesë të plotë dokumentacioni dhe në kundërshtim me aktet ligjore.
Situata: Nga auditimi u konstatua se, të dhënave shtetërore të sistemit LIMS në ISUV administrohen nga OE që kryen mirëmbajtjen e sistemit, në mungesë të plotë dokumentacioni dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, "*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: "*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*"
dhe VKM nr. 673, pika 5/y " *Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*"**.**
Detyrat janë përcaktuar verbalisht në mungesë të plotë dokumentacioni për konfigurimet dhe indeksimet që janë ndërtuar për mirëfunksionimin e saj, si dhe në mirëbesim për ndërhyrjet e pa monitoruara nga ISUV, çfarë përbën një risk shumë të lartë të gabimeve njerëzore apo të qëllimshme dhe ndërprerjen e punës si dhe më e rëndësishmja situata aktuale nuk të jep mundësinë të identifikohet përgjegjësi. ISUV nuk ka një përfaqësues, i cili mund të monitorojë ecurinë e mirëmbajtjes së sistemit.
Kriteri: Ligji nr. 10325, "*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: "*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*"
VKM nr. 673, pika 5/y ". *Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*"**.**
Ndikim/Efekti: Risk shumë i lartë i gabimeve njerëzore apo të qëllimshme me pasojë ndërprerjen e punës, cenimin e të dhënave si dhe pamundësi të identifikimit të përgjegjësit, për ndërhyrje të paautorizuar.
Shkaku: Mungesa e strukturës së brendshme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave e sistemeve të informacionit, mos zbatim i ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, për "*Bazat e të dhënave shtetërore*",
Rëndësia: E lartë
5.1. Rekomandimi: Niveli drejtues në ISUV si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore të sistemit LIMS, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

Për sa është konstatuar më lart, mbi Auditimi i sistemeve, mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat,mbajnë përgjegjësi: z. A.R. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të

Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, znj. J.B. në cilësinë e Zëvendëstitullares, znj. E.K. në cilësinë e Specialistes TI.

*Për sa është trajtuar nëpikat e RaportitPërfundimtar të Auditimitështë mbajtur:*Aktkonstatimi nr.1, datë 02.11.2021,*protokolluar në ISUV menr.893 prot,* datë 02.11.2021. *në ISUV;* Aktkonstatimi nr.2, datë,12.11.2021,*protokolluar në ISUV menr.893/1 prot.,* datë,12.11.2021*;* Aktkonstatimi nr.3, datë 17.11.2021; *protokolluar në ISUV me nr.893/2 prot.,* datë 17.11.2021*;*Aktkonstatimi nr.4, datë 18.11.2021;*protokolluar në ISUV menr.893/3prot.,* datë 18.11.2021*dhe* Aktkonstatimi nr.5, datë 18.11.2021.*protokolluar në ISUV menr.893/4 prot.,* datë 18.11.2021,*si dhe është trajtuar në faqet 8-37të Projektraportit të Audititim, mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin e Auditimit por me shkresën nr973/5 datë,09.12.2021protokolluar në KLSH dheme shkresën nr. 938/1 datë 07.12.2021. protokolluar në ISUV, subjekti i audituar ka pranuar të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e Projektraportit të Audititim të dërguar me shkresën nr.973/4 datë 03.12.2021në ISUV.*

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka të miratuar respektivisht nga MBZHR dhe AKSHI, "*Rregulloren e Organizimit të Brendshëm të Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë*" dhe Rregulloren për Sigurinë e Informacionit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, në faqet 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
1.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në bashkëpunim me MBZHR dhe AKSHI-n duhet të marrë masa për miratimin e rregulloreve në bazë të së cilave institucioni mbështet veprimtarinë e tij.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk disponon strategji të Teknologjisë së Informacionit. Po ashtu, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nuk disponon as një strategji institucionale.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, në faqet 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
2.1. Rekomandimi:ISUV duhet të ndërmarrë masa për ndërtimin e një plani strategjik për teknologjinë e informacionit, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave që ISUV zotëron dhe përpunon, në të cilën të adresohen qartë objektivat e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV ka mungesë në burimet njerëzore. Struktura aktuale e funksionimit të ISUV bëhet në zbatim të**Urdhrit nr. 126, datë 23.10.2020 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISUV*", e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave. ISUV ka në strukturën e tij të miratuar një numër total prej 99 punonjësish. Aktualisht, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë 12 vende vakante, për të cilat institucioni duhet të ndërmarrë masa për ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke kryer rekrutime, me qëllim plotësimin e strukturës.**
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, në faqet 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
3.1. Rekomandimi:ISUV duhet të ndërmarrë masa për plotësimin e kapaciteteve njerëzore duke bërë rekrutime me qëllim plotësimin e strukturës së institucionit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi**u konstatua se**Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në strukturën e tij, ka vetëm një specialist TI, i cili është në varësi të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe përshkrimi i tij i punës bëhet sipas rregullave në fuqi të DAP.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime për kualifikime profesionale brenda dhe jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi. Po ashtu, ka rezultuar se institucioni nuk ka identifikuar nevojat, nuk ka hartuar një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin stafin në rritjen profesionale, certifikimin dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Trajnimet që punonjësit kryejnë nga ASPA nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e stafit për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, në faqet 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
4.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë duhet të ndërmarrë masa për identifikimin e nevojave për specialist TI dhe ngritjen e një strukture TI duke bërë

gjithashtu edhe identifikimin e nevojave për trajnim, hartimin e planeve të trajnimeve dhe kryerjes së tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit "*Blerje e Vogël*" me vlerë nën 100.000 lekë u konstatua se procedurat janë zhvilluar pa hartuar procesverbalet sipas formularit nr. 5 të Udhëzim nr. 3, datë 27.01.2015.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
5.1. Rekomandim: ISUVnë të ardhmen në zhvillimin e procedurave të prokurimit "*Blerje e Vogël*" me vlerë nën 100.000 lekë të hartojë procesverbalet përkatëse.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit: "*Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2020*" dhe "*Shërbim Marrëdhënie me publikun të vitit 2021*" u konstatua se, nuk janë përcaktuar Specifikimet teknike për shërbimet që do të kryhen.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
6.1. Rekomandim:ISUV në të ardhmen në procedurat që do të kryej duhet të marrë masa që në termat e referencës, të përfshihet objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës sëprokurimit "*Shërbim Marrëdhënie me publikun 2020*" u konstatua se, nuk ka një situacion që të përcaktoj vlerën e secilit shërbim që kryhet.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
7.1. Rekomandim: ISUV në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në të ardhmen duhet ti kërkojë kontraktuesit së bashku me raportet mujore dhe situacionin e shërbimeve të kryera**.**

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "*Shërbim internet për Institucionin për vitet 2020 dhe 2021*" dhe procedurës së prokurimit"*Mirëmbajtjen e sistemit LIMS*", -*në Njësinë e Prokurimit dhe në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka specialist të fushës së Teknologjisë së Informacionit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
8.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të prokurimit, gjatë krijimi të Njësive të Prokurimit dhe të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave, të bazohen në kornizat ligjore dhe rregullative dhe të përfshijnë specialist të fushës përkatëse të procedurës së prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua seniveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI, Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kryhen në mungesë të një marrëveshje midis palëve, kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 "*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*".
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
9.1. Rekomandim: ISUV në bashkëpunim me MBZHR t'i kërkojnë AKSHI-t lidhjen e një marrëveshje nivel shërbimi, për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve që AKSHI kryen ndaj ISUV.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në nenin 9 tëkontratës së mirëmbajtjes sistemit LIMS është përcaktuar një shumë prej 4,000,000 lekësh (pa TVSH) që AutoritetiKontraktor duhet ti parapaguajë Operatorit Ekonomik. Shuma e parapagimit i është bashkangjitur situacionit të mirëmbajtës. Parapagimi është në kundërshtim me udhëzimin nr. 9 datë 20.07.2018 për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit në të cilin thuhet se: *Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/nënligjor. Në këto raste paradhënia mund të jetë deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. Struktura përgjegjëse për thesarin evidenton vlerën totale të çdo kontratë/urdhër prokurimi, si dhe grafikun e shlyerjes së kontratës, pasi vërtetohet ekzistenca e fondeve buxhetore vjetore të mjaftueshme në SIFQ, për pjesën e vitit korrent të kontratës, të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit në strukturën përkatëse buxhetore. Vlera e mbetur e kontratës shumëvjeçare regjistrohet për vitet pasardhëse*.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
10.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit dhe personat e autorizuar mbi ndjekjen e procedurave të prokurimit, në procedurat e ardhshme të bazohen në përcaktimet e kornizave ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimimbi plotësimin e kërkesave kontraktuale mbi mirëmbajtjen e sistemit "LIMS" u konstatua se raportetmujore nuk japin informacion mbi punën e kryer, por japin një konfirmim me "OK" që komponentët e sistemit janë funksional dhe kontrollet janë kryer, siç është kërkuar në specifikimet teknike Specifikimeve Teknike të përcaktuara në Nenin 8,pika 3 të kontratës së mirëmbajtjes së sistemit "Lims".
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
11.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë procedurat ligjore dhe kontraktuale të marrjes në dorëzim të shërbimeve.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimimbi kryerjen e shërbimit "*Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019*", u konstatua se procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimeve e ka firmosurnjë prej punonjësve, pa një urdhër nga titullari, në procesverbalin e mbajtur më datë 02.12.2019 mbi kryerjen e shërbimit "*Mirëmbajtje e sistemit LIMS 2019*" me kompaninë A. sh.p.k.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
12.1. Rekomandim: ISUV në të ardhmen të zbatojë të gjitha kornizat ligjore në delegimin dhe ndarjen e përgjegjësive në procedurat e prokurimeve.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka regjistër risku insitucional. Nuk i menaxhon risqet institucionale dhe mbi teknologjinë e informacionit. Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucional.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
13.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut instiucional si dhe atë të teknologjisë së informacionit, në mënyrë që të analizohen dhe vlerësohen risqet dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se faqja web e ISUV nuk ka elemente të sigurisë për garantimin e navigimit të sigurt në të. Portali nuk përdor një lidhje të sigurtë, (connectionsecurity) HTTPS (HyperTextTransferProtocolSecure).
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
14.1. Rekomandimi:ISUV duhet të ndërmarrë masa për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e faqes web me elementët përkatës të sigurisë së navigimitonline për të rritur sigurinë.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka implementuar kontrolle të qendërzuara dhe rrezikon kompromettimin e sigurisë së infrastrukturës network. Nuk përdor ActiveDirectory për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
15.1 Rekomandimi:ISUV të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e qendërzuar dhe të sigurt të rrjetit të ISUV nëpërmjet implementimit të ActiveDirectory.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka marrë masa për sigurimin e vazhdueshmërisë së punës dhe të ruajtjes së informacionit. Nuk ka plan për vazhdimësinë e biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat.
ISUV, nuk ka dokumentim/implementim të planeve mbi sigurinë e informacionit. ISUV nuk ka dokumentacion përsa i përket planit të vazhdueshmërisë së punës (BCP).
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
16.1. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit, duke përfshirë planet për backup, sistemet dhe pajisjet kompjuterike.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sigurinë e bazës së të dhënave të sistemit LIMS për periudhën 01.01.2019 deri më 30.06.2021 u konstatua se janë kryer veprime duke krijuar 951 "Hendeqe" në fushën ID. Ky konstatim tregon se të dhënat kur hidhen në sistem nuk marrin numrin e IDinkrimental rritës, si pasojë krijohet mundësia për ndryshimin e të dhënave në sistem dhe nuk është e mundur ndjekja e rrjedhës historike të dhënave të sistemit. Nisur sa më sipër personat të cilët kanë akses në bazën e të dhënave kanë kryer sistemime apo fshirje të të dhënave duke gjeneruarID me Hendeqe, pa autorizim nga personat përgjegjës në ISUV.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
17.1. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për verifikimin e situatës së krijuar në lidhje me "Hendeqet" në fushën ID, duke hartuar rregullore për përdoruesit dhe administratorët e sistemit LIMS.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISUV nuk ka dhome serverësh, por janë 2 zyra të përshtatura si dhoma serverësh të cilat nuk plotësojnë standardet e përcaktuara sipas rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve miratuar nga AKSHI.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
18.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për ndërtimin e ambienteve të dhomës të serverëve në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se:

Menuja-Regjistra-Nën menuja Formularë Shoqërimi- qeliza KODI (përveç të dhënave numerike që duhet të marrë dhe duhet të ishte standarde) kjo fushë merr karaktere të tjera si shkronja "e", shenjat e pikësimit pikë "." dhe presje ",".
- Në menunë "*Subjekti që ka kërkuar provën*", përveç emrave të personave apo subjekteve të cilët sjellin provat për t'u kryer analizat, në këtë fushë dalin dhe numrat "147,148, 89" dhe karakteri vizë "-".
- Tek fusha "*Mënyra e kampionimit*" lejon të shkruhen numra dhe karaktere, ndërkohë që duhet të jetë e parapërcaktuar si fushë, pasi janë vetëm 3 mënyra kampionimi "*1. r., 2. z., 3. g..*"
- Nga 659 veterinerë të regjistruar, 507 prej tyre janë aktiv. Nga 507 veterinerë aktiv rezulton se 392 ose 77% prej tyre nuk kanë të regjistruar në sistem numrin e telefonit dhe adresën e e-mailit.
Vetëm 115 ose 23% e veterinerëve kanë të dhëna të plota në databazën e LIMS.
- Nga 58 pozicione pune për të cilët janë paraqitur të dhënat, 15 prej tyre nuk kanë numër telefoni në sistem.
- Fusha WorkPostion, ka disa qeliza që duhet të kenë përshkrimin e punës. Edhe pse janë pa përshkrim pune, këto pozicione pune me userID përkatës: "..,..,..,..,.." janë aktive dhe kanë numër telefoni.
- Përdoruesit me user: "*a., s. dhe s."* janë usera në të cilët nuk janë përcaktuar personat përgjegjës që i përdorin. Gjithashtu këta 3 usera kanë akses për kryer çdo lloj veprimi në databazë.
- Punonjësja E.N. me user "e." është larguar nga puna më datë 01.0..20.. por u konstatuase është loguar në sistem më 14.....20.. ose katër muaj pasi është larguar nga puna. Ndërsa punonjësja B.K. me user "b."ka marrë akseset e sistemit LIMS me detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse, por nuk e ka përdorur asnjëherë sistemin.
- Punonjësit të cilët janë larguar, shfaqen në menunë Staf edhe pse janë të çaktivizuar. Gjithashtu të dhënat dhe veprimtaria e tyre duhet të ruhen edhe pasi të largohen për një periudhë kohe sipas ligjit të dokumentit elektronik.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 28-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
19.1. Rekomandimi: ISUV të marrë masa për analizimin e situatës aktuale në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave që përmbajnë sistemet informatike të LIMS duke përcaktuar edhe shkaqet prej të cilëve rrjedhin problematikat e konstatuara. Të merren masat e nevojshme për ngritjen dhe implementimin e mekanizmave të kontrollit dhe validimit të inputit të sistemeve informatike, duke përcaktuar tipin e të dhënave që mund të plotësojnë përdoruesit në përputhje me formatin dhe informacionin që përmban secila prej fushave, me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të konstatuara.
19.2. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për plotësimin e sistemit LIMS të të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.
19.3. Rekomandimi:ISUV të marrë masa për ndërtimin e mekanizmave të kontrollit për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.
18.4. Rekomandimi:ISUV të marrë masa që të mos shfaqen në ndërfaqen Web të LIMS, punonjësit e larguar nga puna ose punonjës të cilët kanë ndryshuar pozicionin e punës dhe i'u është hequr aksesi nga sistemi LIMS, por të ruhet veprimtaria e tyre në data bazë e sistemit.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në sistemin LIMS u konstatua se:
- Ky sistem nuk të jep mundësinë e filtrimit dhe gjenerimit të raporteve.

-Nuk ka eksport për të dhënat (informacionet) jep vetëm total rekordesh.
Mungesa e gjenerimit të raporteve sjell pamundësinë e monitorimit të sistemit, mospërdorimin e data bazës për analizime statistikore dhe raportime javore ose mujore në varësi të nevojave të institucionit, si dhe mungesën e politik bërjes specifike sipas rajoneve, grupeve ushqimore, grup kafshësh, etj.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 28-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
20.1. Rekomandimi:ISUV të kërkojë tek OE përmbushjen e funksionaliteteve që mungojnë, për gjenerimin e raporteve javore, mujore sipas nevojave të institucionit, analizime statistikore dhe monitorimin e veprimtarisë së sistemit LIMS.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se politikat e vendosjes se fjalëkalimeve në sistemin LIMS nuk janë në përputhje me "*Kërkesat e Sigurisë*" përshkruar në "*Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike*", miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)*;*
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 28-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
21.1. Rekomandimi:ISUVtë marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit LIMS ku të identifikohen qartë:

- rregullat e monitorimit,
- politikat e implementuara për fjalëkalimet e administrimitdhe përdoruesit fundor
- të dhënat e detyrueshme që nevojiten të plotësohen për çdo përdorues
- të dhënat e pandryshueshme për secilin prej tyre,
- ndalimin e krijimit të më shumë se një përdoruesi për punonjës
- ndalimin e krijimit të një përdoruesi të ri për punonjësin ekzistues.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, pavarësisht se databaza e sistemit LIMS është miratuar si databazë shtetërore ISUV nuk ka ndërmarrë hapa të mëtejshme për ndërveprimin e saj me databazat e institucioneve të tjera.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 28-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
22.1. Rekomandimi: ISUV me qëllim rritjen e efektivitetit të ndërsjelltë të të dhënave që mbahen në sistemin LIMS në bashkëpunim me AKSHI-n dhe MBZHR të identifikojnë fushat e ndërveprimit të databazësLIMS me databazat e institucioneve të tjera për arritjen e ndërveprimit në fushat e interesit reciprok.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, të dhënave shtetërore të sistemit LIMS në ISUV, administrohen nga OE që kryen mirëmbajtjen e këtij sistemi, në mungesë të plotë dokumentacioni dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 10325, "*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: "*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*"
dhe VKM nr. 673, pika 6/y "*Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*"**.**
Detyrat janë përcaktuar verbalisht në mungesë të plotë dokumentacioni për konfigurimet dhe indeksimet që janë ndërtuar për mirëfunksionimin e saj, si dhe në mirëbesim për ndërhyrjet e pa monitoruara nga ISUV, çfarë përbën risk shumë të lartë të gabimeve njerëzore apo të qëllimshme dhe ndërprerjen e punës si dhe më e rëndësishmja situata aktuale nuk të jep

mundësinë të identifikohet përgjegjësi.ISUV nuk ka një përfaqësues, i cili mund të monitorojë ecurinë e mirëmbajtjes së sistemit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 28-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
23.1. Rekomandimi: Niveli drejtues në ISUV si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore të sistemit LIMS, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e prokurimit "Mirëmbajtjen e sistemit LIMS", grupi auditimit analizoi komponentët e përshkruar në raportet e mirëmbajtjes mbi operimin e këtyre komponentëve onsite në sistem.
Nga auditimi onsite në sistem u konstatua se nga 13 komponentë në total të përshkuara dhe kërkuara në kontratën e mirëmbajtjes së sistemit LIMS**,** 7(shtatë) prej këtyre komponentëve **n**uk janë të implementuara. Për këto komponentë Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa sipas raporteve dhe faturave të paraqitura nga Kontraktori (OE) (A. Shpk), me vlerën 1,704,000 Lekë., vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit..
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, në faqet 14-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
1.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin e shumës 1,704,000 lekë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit pasi është përfituar padrejtësisht nga Kontraktuesi A. sh.p.k.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

Raporti i Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi i Kryetarit të KLSH-së, do të përcillet krahas subjektit të audituarInstitutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë- ISUV,Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural -MBZHRdhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT